



**UNIVERSITETI  
ALDENT**

# **Konferenca e I<sup>-rë</sup> Shkencore Studentore**

**3 Qershor, 2016**



---

## **Komiteti Shkencor:**

Prof. Dr. Afrim Tabaku  
Prof. Dr. Adem Alushi  
Prof. Asoc. Dr. Agim Shehi  
Dr. Enver Mustafaj  
Dr. Enkelejda Goci  
Dr. Entela Haloci  
Dr. Jorida Shahinas  
Dr. Edlira Dedaj  
Dr. Rezarta Shkreli

---

## **Komiteti Organizues:**

Prof. Dr. Afrim Tabaku  
Dr. Enkelejda Goci  
Jesmina Kolushi  
Luciano Zallemi  
Adela Alushi  
Aleksandër Damzi

---

## **Design:**

**AVANTGARDE**  
graphic design & handmade

---

## **Press:**

SHTËPIA BOTUESE  
**mediaprint**

---

ISBN 0123456789XXX

Adresa: **Rr. e Dibrës, Nr. 235, Tek Selvia, Tiranë-Shqipëri**  
Email: [info@ual.edu.al](mailto:info@ual.edu.al)  
Web: [www.ual.edu.al](http://www.ual.edu.al)  
Telefon: 04 2419036  
Celular: (+355) 69 20 75216, 069 40 30003

---

**BESONI TEK PROFESIONISTËT**



**UNIVERSITETI  
ALDENT**

**Konferenca e  
Shkencore Studentore I<sup>-rë</sup>**

**3 Qershor, 2016**

---

***BESONI TEK PROFESIONISTËT***



---

### **Komiteti Shkencor:**

Prof. Dr. Afrim Tabaku  
Prof. Dr. Adem Alushi  
Prof. Asoc. Dr. Agim Shehi  
Dr. Enver Mustafaj  
Dr. Enkelejda Goci  
Dr. Entela Haloci  
Dr. Jorida Shahinas  
Dr. Edlira Dedaj  
Dr. Rezarta Shkreli

---

### **Komiteti Organizues:**

Prof. Dr. Afrim Tabaku  
Dr. Enkelejda Goci  
Jesmina Kolushi  
Luciano Zallemi  
Adela Alushi  
Aleksandër Damzi

---

### **Design:**

**AVANTGARDE**  
graphic design & handmade

---

### **Press:**

SHTËPIA BOTUESE  
**mediaprint**

---

ISBN 0123456789XXX

---

Adresa: Rr. e Dibrës, Nr. 235, Tek Selvia, Tiranë-Shqipëri  
Email: [info@ual.edu.al](mailto:info@ual.edu.al)  
Web: [www.ual.edu.al](http://www.ual.edu.al)  
Telefon: 04 2419036  
Celular: (+355) 69 20 75216, 069 40 30003

## **HYRJE**

---

Nisur nga dëshira për të rritur pjesëmarrjen në fushën e kërkimit shkencor dhe për të promovuar idetë dhe iniciativat profesionale sidomos në fushën farmaceutike dhe stomatologjike Universiteti ALDENT, me mbështetje të Qendrës Kërkimore Farmakoterapeutike dhe Qendrës së Shërbimit Klinik, ju fton të jeni pjesëmarrës në Konferencën e parë Shkencore Studentore.

Universiteti ALDENT në organizimin dhe funksionimin e tij ka pjesë të pandarë të misionit kërkimin shkencor gjithëpërfshirës. Promovimi dhe stimulimi i studentëve është ndër detyrat prioritare të stafit akademik të Universitetit ALDENT.

Studentët tanë kanë qenë pjesëmarrës aktiv në shumë konferenca dhe kongrese të organizuara nga shoqatat studentore ndëruniversitare.

Kjo konferencë synon të mbledhë së bashku studentë e pedagogë për të vënë në dukje punën e tyre kërkimore në fusha të ndryshme të farmacisë dhe stomatologjisë. Ky debat do të shërbejë si premisë në adresimin e kërkimit shkencor dhe krijimit të linjave të miniprojekteve në bazë fakultetesh dhe ndër institucionale në të ardhmen.

Si pjesë e aktivitetit mësimor-shkencor, ky organizim do t'i mundësojë studentëve të nivelit Master në Farmaci e Stomatologji të prezantojnë projektet dhe studimet e tyre të deritanishme, duke gjetur në këtë Konferencë një mundësi shumë të vlefshme për promovimin e punës së tyre.

Këshilli Shkencor i Universitetit ALDENT, do të synojë në rritjen e cilësisë së punimeve shkencore, si një domosdoshmëri e zbatimit të filozofisë së shkollës tonë, por edhe në zbatim të kërkesave të ligjit të ri të Arsimit të lartë.

Me këtë rast stafi drejtues i Universitetit ALDENT ju uron punë të mbarë dhe suksese në zhvillimin e konferencës së parë shkencore studentore.

## PËRMBAJTJA

### Departamenti i Farmacisë

Nivelet e karboksihemoglobinës në popullatën që jeton në zonën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës	6
Kontrulli i cilësisë së tabletave të acidit acetilsalicilik 100 mg që qarkullojnë në tregun shqiptar	7
Indikatorët bazë të vlerësimit të përdorimit racional të barnave	8
Ndërveprimet e barnave dhe roli i farmacistit	9
Njohja me përbërësit dhe vetitë antiinflamatore të shelgut të bardhë	10
Vlerësimi i njohurive të stafit mjekësor për farmakovigilencën dhe raportimin e reaksioneve të padëshirueshme të barnave	11
Një vështrim mbi vetitë mjekësore të achillea millefolium	12
Sistemi i edukimit farmaceutik në Shqipëri, vendet e rajonit si dhe në disa vende të BE-së	13
Analiza farmaceutike dhe profilet e disolucionit së tabletës së plotë dhe të ndarë të atenololit	14
Kontrulli farmaceutik i disa formave farmaceutike të ngurta afër dhe disa muaj pas datës së skadimit	15
Produktet zbardhuese të lëkurës me përmbytje të lartë hidrokinoni	16
Parimet bazë të dizenjimit të barnave	17

### Departamenti i Stomatologjisë

Principet e pozicionimit gjatë procedurave dentare	18
Barodontalgjia	19
Kandidoza orale dhe stomatiti protetik tek të protezuarit me proteza të lëvizshme	20
Shkaqet e dështimeve endodontike	21
Menaxhimi dhe trajtimi i osteomielitit kronik në mandibul (Raportim rasti)	22
Traumat dentare	23
Hepatitet dhe risku i tyre në kabinetet dentare	24
Sëmundja periodontale dhe pasojat e saj në shtatzëni	25
Vlerësimi i preparimit të margos gingivale në punimet fikse	26
Risqet në Kabinet/Klinika Dentare	27

# Abstrakte

# Nivelet e karboksihemoglobinës në popullatën që jeton në zonën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës

**FIGORELA SEFA; JESMINA KOLUSHI; ANISA KUSTA**  
**Prof. Dr. AFRIM TABAKU\***

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

\*Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Në zonat naftëmbajtëse ajri është i ndotur nga një mori ndotësish organike si dhe monoksid karboni që vjen si rezultat i djegies së gazit që çlirohet nga pusët e naftës dhe të gazit që përdoret në banesa për ngrohje dhe gatim në soba të paventiluara. Qëllimi i këtij punimi ka qenë njohja me nivelet e karboksihemoglobinës në popullatën e pellgut naftëmbajtës të Patos-Marinzës si dhe propozimi për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës së zonës.

**Materiali dhe metoda:** Ne kemi kryer një vëzhgim retrospektiv në 110 qytetarë të rritur që jetonin dhe punonin në këtë zonë. Të dhënat për përmbajtjen e karboksihemoglobinës janë marrë nga shërbimi i sëmundjeve profesionale të Spitalit Rajonal të Fierit. Rezultatet e marra janë përpunuar statistikiisht duke përdorur paketën statistikore Statistical Package for Social Sciences (SPSS 15).

**Rezultatet dhe diskutimi:** Nivelet e karboksihemoglobinës në banorët e kësaj zone luhateshin nga  $3.4423 \pm 0.2245$  në femrat dhe nga  $4.734 \pm 0.2184$  në meshkujt dhe ndryshimet ndërmjet dy grupeve rezultuan sinjifikante ( $P = 0.05$ ). Duke patur parasysh se nivelet e mbi 2.5% të karboksihemoglobinës përdoren për vlerësimin e riskut të popullatës së ekspozuar, në mënyrë të veçantë për popullatën që vuan nga angina pectoris, në studimin tone deri në këtë nivel rezultuan 19.23 % e grave dhe 13.09% e burrave, ndërsa në nivelin 2.6 – 5.0% rezultuan 80.76% femrave dhe 50% e meshkujve. Me nivele më të larta se 5% kane rezultuar meshkujt ku deri në 8% janë 29.76% dhe mbi 8.1% COHb kanë rezultuar 7.14% e meshkujve

**Konkluzione:** Nga analiza e kryer rezultoi se vetëm një pjesë e vogël e popullatës së marrë në studim kanë nivelet e karboksihemoglobinës brenda normave të lejuara, ndërsa pjesa më e madhe e popullatës kanë nivelet më të larta se normat e lejuara, prandaj duhen marrë masat e duhura për të ulur shkallën e ekspozimit të popullatës.

**Fjalë kyçe:** Karboksihemoglobinë, monoksid karboni, ndotës organikë, zonë naftëmbajtëse.

# Kontrolli i cilësisë së tabletave të acidit acetilsalicilik 100 mg që qarkullojnë në tregun shqiptar

---

**ELONA ALLMUÇA; LORELA GRECA; JONA MJALTI**  
**Dr. ENKELEJDA GOCI\***

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

\*Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Acidi acetilsalicilik (aspirina – ASA) është një bar i rëndësishëm i grupit të antiinflamatorëve josteroidë, me veprim analgjezik, antipiretik dhe antiinflamator. Përdorimi i tij është shumë efikas në trajtimin e sëmundjeve të ndryshme të zembrës dhe qarkullimit të gjakut. Efikasiteti i aspirinës në parandalimin e infarktimit të miokardit është e lidhur me parandalimin e formimit të trombeve duke ngadalësuar agregimin e qelizave të gjakut. Tabletat me çlirim të vonuar janë përdorur për rritjen e biodisponibilitetit dhe për të zvogëluar riskun e shtrimit në spital shkaktuar nga sëmundjet e zembrës. Shumë barna të përgatitura me aspirinë tregtohen si barna OTC. Në tregun shqiptar janë të pranishme dhe të regjistruara në listën e rimbursimit gjashtë lloje të tabletave 100 mg të acidit acetilsalicilik.

**Qëllimi** i këtij studimi është vlerësimi farmakopeal i tabletave të acidit acetilsalicilik gastrorezistente që qarkullojnë në tregun shqipëtar.

**Materiali dhe metoda:** U përzgjedhën nga barnat e regjistruara në Republikën e Shqipërisë tableta gastrorezistente të acidit acetilsalicilik 100 mg. Metodika e analizave që u përdor bazohej në monografinë farmakopeale BP 2007. Tabletat iu nënshtruan kontrollit organoleptik, fizik dhe atij kimik. Gjatë këtij vlerësimi tabletave iu përcaktuan pesha mesatare, qëndresa mekanike, koha e zbërthimit, shpejtësia e tretjes si dhe përcaktimi cilësor dhe sasior u krye me anën e metodave analitike si titullimi apo spektrofotometri UV-VIS.

**Rezultatet dhe konkluzionet:** Tabletat e përzgjedhura që iu nënshtruan vlerësimit nuk paraqitën ndryshime të rëndësishme duke iu referuar limiteve farmakopeale. Gjatë identifikimit cilësor në secilin rast u konfirmua prania e aspirinës. Përcaktimi sasior me të dyja metodat e përdorura dha vlera të përafërta dhe prani të lëndës vepruese në kufijtë 92 – 105% të sasisë së deklaruar.

**Fjalëkyçe:** tableta gastrorezistente, acid acetilsalicilik, kontroll fizik, kontroll organoleptik, kontroll kimik.



# Indikatorët bazë të vlerësimit të përdorimit racional të barnave

**EDJONA BAJRAKTARI; ERLIND JAHOLLARI; ERALDA RAMI; KITAIRDA XHIKA**  
**Prof. Dr. AFRIM TABAKU\***

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

\*Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Për të kryer promocion për përdorimin racional të barnave në vendet në zhvillim është e rëndësishme të vlerësohen modelet ekzistuese të përdorimit të barnave duke përdorur indikatorët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Qëllimi i këtij punimi ka qenë të vlerësojë mënyrat e përshkrimit të barnave në disa farmaci në qytetin e Tiranës duke përdorur disa nga indikatorët bazë për vlerësimin e përdorimit racional të barnave

**Materiali dhe metoda:** Është kryer një studim ndër seksional në tre farmaci të qytetit të Tiranës për të përcaktuar praktikatat që ndiqen sot për përshkrimin e barnave në qytetin e Tiranës. Nga 440 receta gjithësejt, janë marrë në mënyrë të randomizuar 84 receta. Këto receta janë analizuar nën aspektin e tre indikatorëve kryesorë, si indikatorët përshkrues, indikatorët e kujdesit ndaj pacientit, indikatorët e shërbimit për shëndetin. Të dhënat e përftuara nga ky vëzhgim u përpunuan me metodën statistikore Statistical Package for Social Science (SPSS 15).

**Rezultatet dhe diskutimi:** Numri i barnave për recetë varioi nga 1 – 5 me një mesatare prej 2.56 barna për recetë. Përqindja e barnave në të cilën përshkruhej një antibiotik luhatet nga 75.19% - 77.27%, përqindja e recetave me emra xhenerike varioi nga 25.37% - 47.72%. Koha e konsultimit farmacist-pacient rezultoi 3.49-5.04 minuta për recetë ndërsa koha e shpërndarjes së barnave u luhat nga 1.07-2.43 minuta. Mbi 99% e barnave shpërndahet menjëherë

**Konkluzione:** Në bazë të këtij vrojtimi arrihet në konkluzion se në të gjitha rastet kemi të bëjmë me polifarmaci, ku përshkrimet e antibiotikëve janë të shumta dhe tregojnë devijime nga standardet e rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Njohuritë e pacienteve përsa i përket dozave të barnave që përdorin në përgjithësi janë të një niveli jo të kënaqshëm. Gjithashtu shumica e përshkrimeve të barnave nuk bëhej me emërtime xhenerike.

**Fjalë kyçe:** Përdorimi racional i barnave, indikatorët bazë të përdorimit racional të barnave të OBSH, mënyrat e përshkrimit të barnave, emërtime xhenerike.

# Ndërveprimet e barnave dhe roli i farmacistit

---

**ERLIND JAHOLLARI**  
**Dr. KLODIOLA DHAMO**

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Ndërveprimi i barnave mund të përkufizohet si ndërveprim i një bari me një tjetër ose barnave me lëndë të tjera, si ushqimet. Ndërveprimet midis barnave mund të ndodhin në pacientët që marrin trajtim me disa barna njëkohësisht. Në disa raste përgjigja terapeutike mund të ndikohet nga prania e ndërveprimeve midis barnave, ose barnave dhe ushqimeve, produkteve bimore, etj. Duke patur parasysh numrin e madh të ndërveprimeve midis barnave, është e vështirë për personelin mjekësor të jetë vazhdimisht i azhornuar.

**Qëllimi** i këtij studimi ka qenë të identifikohen llojet e ndërveprimeve dhe të verifikohet shpeshtësia e tyre në recetat e përshkruara dhe kartelat mjekësore spitalore.

**Materiali dhe metoda:** Për të përcaktuar shtrirjen e këtij problemi, ndërmorëm një vërtetim 3 mujor në kartelat spitalore dhe një numër të madh recetash të ekzekutuara në farmacitë të marra në mënyrë rastësore në qytetin e Tiranës.

**Rezultatet dhe diskutimi:** Nga ana jonë janë analizuar për mundësinë e shfaqjeve të ndërveprimeve të barnave 50 receta të paraqitura në farmaci, 20 kartela pediatrike, 13 kartela poliklinike dhe 13 kartela patologjike. Nga analiza që iu bë rezultoi se në shumicën e rasteve kishte mundësi për shfaqjen e ndërveprimeve ndërmjet barnave të përshkruara. Nga gjithë ndërveprimet, më i shpeshti ishte ndërveprimi clopidogrel-omeprazol i cili konsiderohet një ndërveprim jo i rëndësishëm klinikisht.

**Konkluzione:** Njohja, identifikimi dhe menaxhimi i ndërveprimeve klinikisht domethënëse ndërmjet barnave është një sfidë për mjekët, farmacistët dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë. Për të ulur frekuencën e ndërveprimeve të mundshme mund të jetë e nevojshme një përzgjedhje e kujdesshme e alternativave terapeutike, bazuar në identifikimin e këtyre ndërveprimeve nëpërmjet programeve të posaçme, futja e figurës së farmacistit klinik në spital, monitorimi i pacientëve për të identifikuar eventet e padëshiruara nga ndërveprimet e barnave.

**Fjalë kyçe:** ndërveprim, receta, kartela spitalore, farmacisti klinik.

# Njohja me përbërësit dhe vetitë antiinflamatore të shelgut të bardhë

**JONA MJALTI; LORELA GRECA; ELONA ALLMUÇA**  
**Dr. ENKELEJDA GOCI\***

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

\*Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Që nga lashtësia, bimët që përmbajnë salicilate janë përdorur si analgjezike dhe antiinflamatore. Salicilatet janë lëndë antiinflamatore jo-steroidale të përfuara nga acidi salicilik. Derivatet kryesore të acidit salicilik janë acidi acetilsalicilik, metilsalicilatet, salicilaldehidet dhe alkooli salicil. Produktet natyrore me derivate salicilike kanë përdorime të gjëra në terapinë tradicionale si lëndë me veti antireumatizmale dhe analgjezike. Vetitë antiinflamatore i atribuohen acidit salicilik të përfuar nga hidroliza e estereve të tij, ose nga oksidimi i alkoolit salicil, e formuar nga hidroliza në intestin e salicinës. Lëvorja e *Salix alba* është e pasur në tanina (3-12%), flavonoide, glikozide fenolike dhe acide fenolike, si: salicin 0.5-1% (glikozide të alkoolit salicil) dhe estere të tij, si salikortin, tremulacin, populin.

**Qëllimi** i këtij studimi është vlerësimi i acideve fenolike në drogën *Salix alba* – shelgu i bardhë dhe i disa treguesve farmakopealë të kësaj bime.

**Materiali dhe metoda:** U përzgjedhën nga tregu lëvorja e *Salix alba*, e identifikuar nga departamenti i Botanikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Droga bimore mjekësore iu nënshtrua kërkesave farmakopeale mbi përmbajtjen e lagështisë dhe hirit. Përcaktimi i acideve fenolike u realizua në ekstraktet ujore, etanolike dhe metanolike të lëvores së bimës. Fillimisht në këto ekstrakte u krye identifikimi i pranisë së acidit salicilik me anën e reaksioneve me ngjyrë dhe kromatografisë në shtresë të hollë (TLC). Përmbajtja e acideve fenolike në ekstraktet e përfuara u përcaktua me anën e metodës analitike të titullimit.

**Rezultatet dhe konkluzionet:** Përmbajtja e acideve fenolike ishte më e lartë në ekstraktet alkolike. Droga e marrë për studim i plotësonte kërkesat farmakopeale në lidhje me përqindjen e lejuar të lagështisë dhe përmbajtjes së hirit total.

**Fjalë kyçe:** shelgu bardhë, acide fenolike, ekstrakte, kromatografi në shtresë të hollë.

# Vlerësimi i njohurive të stafit mjekësor për farmakovigjilencën dhe raportimin e reaksioneve të padëshirueshme të barnave

---

**JONA BERBERI; ELONA ALLMUÇA; MIMOZA XHAFA; XHULIANA DEMKA**  
**Prof. Dr. AFRIM TABAKU\***

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT  
\*Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Reaksionet e padëshirueshme të barnave përbëjnë një nga shkaqet më kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në shumë vende, si dhe ndikojnë në rritjen e kostos së kujdesit shëndetësor. Këto reaksione meqë nuk raportohen gjithmone përbëjnë një problem madhor të shëndetit publik.

**Materiali dhe metoda:** Është kryer një punim ndër-sektional në 299 punonjës të kujdesit shëndetësor (mjekë, farmacistë dhe infermierë) duke përdorur një pyetësor. Pyetësi përmbante 31 pyetje të ndara në 8 rubrika nëpërmjet të cilave grumbulloheshin informacione mbi të dhënat demografike, për njohuritë e tyre mbi miratimin e neneve të farmakovigjilencës në ligjin e barnave, për përkufizimin e farmakovigjilencës dhe qëllimin e saj, për njohuritë dhe praktikën e raportimit të ADR-ve, mbi mendimet e personelit mjekësor në lidhje me raportimin e këtyre reaksioneve si dhe për arsyet e mosraportimit të këtyre reaksioneve.

**Rezultatet dhe diskutimi:** Nga ky studim doli se 35 – 40% e të intervistuarve kanë dhënë përgjigje të saktë në lidhje me përkufizimin e farmakovigjilencës, ndërsa për qëllimet e saj 32 – 60% dhanë përgjigje të drejtë. Pjesa më e madhe e të intervistuarve ishin të mendimit se personeli mjekësor ka për detyrim raportimin e ADR-ve, porse niveli i dokumentimit të këtyre linte për të dëshiruar. Pothuajse i gjithë stafi mjekësor i përfshirë në studim kishte parë ADR, por asnjë rast nuk ishte raportuar në qendrën e farmakovigjilencës. Arsyet për mos raportimin e këtyre reaksioneve lidheshin me paqartësinë e plotësisht të formularit përkatës 11 – 50%, dhe mos pasjen e formularit të raportimit të ADR-ve 20 – 43%.

**Konkluzione:** Nga ky punim doli se është nevojë urgjente përmirësimi i njohurive dhe praktikave të stafit mjekësor në lidhje me farmakovigjilencën dhe raportimin e ADR-ve në mënyrë që të mbrohet shëndeti i pacientëve. Kurrikulat e shkollave mjekësore duhet të rishikohen duke inkluduar edhe konceptet e farmakovigjilencës.

**Fjalë kyçe:** Raportimi i ADR-ve, farmakovigjilencë, mjekë, farmacistë, infermiere.

# Një vështrim mbi vetitë mjekësore të achillea millefolium

**LORELA GRECA; JONA MJALTI; ELONA ALLMUÇA**  
**Dr. EDLIRA NEZA\*; Dr. ENKELEJDA GOCI\***

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

\*Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Achillea millefolium L.(Asteraceae) është përdorur në mjekësinë tradicionale të disa kulturave, nga Evropa në Azi. Pasuria e saj në komponimeve bioaktive kontribuon në një gamë të gjerë të vetive mjekësore të saj. Oë nga viti 1975, janë raportuar shumë studime mbi përbërjen fitokimike të A. millefolium dhe kjo çoji në identifikimin e flavonoideve. Lidhur me bioaktivitetin e kësaj bime, studimet e fundit kanë raportuar veti antimikrobiale, antiflogjistike, hepatoprotektive, antispasmodike, etj. Është sugjeruar se vetitë antiinflamatore, koleretike dhe citotoksike të llojeve të gjinisë Achillea i atribuohen kryesisht flavonoideve dhe komplekseve të acideve fenolkarbonike.

**Qëllimi** i këtij studimi ka qenë vlerësimi i flavonoideve totale në drogën Achillea millefolium -mijëfletëshi shqiptar.

**Materiali dhe metoda:** U përzgjedhën nga tregu bima e plotë e Achillea millefolium, e identifikuar nga departamenti i Botanikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Droga bimore mjekësore iu nënshtrua kërkesave farmakopeale mbi përmbajtjen e lagështisë dhe hirit. Përcaktimi i flavonoideve total u realizua në ekstraktet ujore, etanolike dhe metanolike të të gjithë bimës. Fillimisht në këto ekstrakte u krye identifikimi i pranisë së komponimeve fenolike me anën e reaksioneve me ngjyrë. Përmbajtja e flavonoideve totale u përcaktua duke përdorur klorur alumini (III) sipas një metode të njohur, si dhe katekinën si lëndë standarde. Ekstraktet e trajtuara sipas Ordonez at al., 2006, u holluan deri në një ml me ujë dhe iu mat absobanca në spektrofotometër UV-VIS, në 510 nm. Rezultatet u shprehën si mg katekin/g drogë.

**Rezultatet dhe konkluzionet:** Përmbajtja e flavonoideve total ishte më e lartë në ekstraktet ujore dhe ato metanolike. Droga e marrë për studim i plotësonte kërkesat farmakopeale në lidhje me përqindjen e lejuar të lagështisë dhe përmbajtjes së hirit total.

**Fjalë kyçe:** Achillea millefolium, flavonoide, ekstrakte, komponime fenolike, katekinë.

# Sistemi i edukimit farmaceutik në Shqipëri, vendet e rajonit si dhe në disa vende të BE-së

**SHPRESA ZHURDA\***; **LINDA ZENELAJ\***; **Dr. ENTELA HALOCI\***  
**Dr. ENKELEJDA GOCI\*\***; **Dr. REZARTA SHKRELI\*\*\***

\*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Mjekësisë; Universiteti i Mjekësisë Tiranë

\*\*Qendra kërkimore Farmakoterapeutike; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

\*\*\*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Profesionin e farmacistit zë një vend shumë të rëndësishëm në kujdesin shëndetësor në tërësi. Rreth 400.000 farmacistë të rrjetit të hapur (komunitare) kontribuojnë në shëndetin e mbi 500 milion njerëzve në gjithë Evropën, nga të cilët 46 milion vizitojnë një farmaci komunitare çdo ditë. E drejta e profesionistëve si qytetarë të BE-së për të punuar në një shtet tjetër anëtar rrjedh direkt nga Traktatet dhe direktivat evropiane. Meqenëse kërkesat e kualifikimit ndryshojnë nga një vend në tjetrin, një profesionist i cili është plotësisht i kualifikuar në një Shtet Anëtar të BE-së mund të hasi vështirësi në ushtrimin e profesionit në një Shtet tjetër Anëtar dhe joanëtar.

Direktiva e vitit 1985 e Komunitetit Ekonomik Evropian (EEC) mbi profesionin e farmacistit, supozon se krahasueshmëria e edukimit në farmaci në gjithë Evropën mund të sigurojë një bazë për njohjen reciproke të diplomave. Direktiva e Kualifikimeve Profesionale 2005/36/EC është një instrument që synon kapërcimin e këtyre vështirësive duke organizuar njohjen e kualifikimeve profesionale. Në vijim të kriterëve të përcaktuara nga kjo direktivë evropiane rreth 34 vende anëtare të BE-se ose vende kandidatë janë organizuar në Unionin Evropian të Grupit Farmaceutik (Pharmaceutical Group of the European Union –PGEU) . Në këtë studim janë paraqitur një sërë shembujsh të sistemit të edukimit dhe sistemit farmaceutik me qëllim për të parë të përbashkëta, si dhe japim informacion në lidhje me to.

**Materiali dhe metodika:** Studimi është i tipi krahasues retrospektiv. Janë marrë informacione nga konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe botime të ndryshme në revista të njohura.

**Rezultatet dhe diskutimi:** Nga ky studim retrospektiv i literaturës u konstatua se lidhur me ndërtimin e kurrikulës dhe programit të studimit, për shkak të implementimit të sistemit të Bolonjës dhe reformave të arsimit të lartë sistemi i edukimit farmaceutik në Shqipëri ka ngjashmëri me disa vende të rajonit edhe anëtare të BE-së në, por vihen re ndryshime të konsiderueshme siç janë me vendet nordike. Në lidhje me sistemin farmaceutik, licensimin, të drejtën e ushtrimit të profesionit organizmat drejtues përkatës Shqipëria shfaqet me ndryshime të konsiderueshme me vendet e BE dhe ka ngjashmëri kryesisht me vendet e Ballkanit. Në lidhje me edukimin në vazhdim jemi në formim e sipër të sistemit edhe pse është zhvilluar mirë vitet e fundit.

**Konkluzione:** Sistemi i edukimit dhe i rrjetit farmaceutik në Shqipëri shfaqet me ngjashmëri me vendet e Ballkanit, dhe ka ndryshime të konsiderueshme me vendet e BE. Duhet të stimulojmë dhe të adaptojmë direktivat e BE, të bëhemi pjesë e konsortiumeve që tentojnë të sheshojnë ndryshimet midis sistemeve farmaceutike në mënyrë që të kapërcehet 'ngërçi' i sistemit farmaceutik aktual.

# Analiza farmaceutike dhe profilet e disolucionit së tabletës së plotë dhe të ndarë të atenololit

---

**ANTIGONA BIBA\*\***

**Dr. ENTELA HALOCI\***

\*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Mjekësisë; Universiteti i Mjekësisë Tiranë

\*\*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Atenololi është një bar i futur tashmë në protokollet rutinë të mjekimit. Shpesh herë për shkak të mungesës të form-dozave të vogla në tregun farmaceutik mjekëve iu duhet të përshkruajnë doza që merren si rezultat i ndarjes së tabletave dhe për rrjedhojë edhe pacientët të cilët janë të detyruar për të bërë një proces ndarjeje të saktë. Për të vlerësuar cilësinë e disa tabletave të atenololit që qarkullojnë në tregun shqiptar farmaceutik si dhe për të vlerësuar profilet e disolucionit të formave të ndara me thyerje dhe me presë, u realizua ky studim.

**Materiali dhe metoda:** Metodat e analizës të zbatuara janë ato të BP(2009), ku u zbatuan të gjitha provat fiziko-kimike për format e ngurta si dhe prova e profileve të disolucionit. Aparati i disolucionit që u përdor është RC-6 Dissolution Center. Standardet që u përdoren janë marrë nga firma Sigma Aldrich. Alternativat tregtare u blenë në mënyrë rastësore në rrjetin farmaceutik. Ndarja e tabletës u bë me thyerje dhe me presë paralelisht.

**Rezultatet dhe diskutimi:** Rezultoi se alternativat tregtare për tabletat e atenololit 100 mg dhe 50 mg të marra në studim ishin brenda limiteve përkatëse farmakopeale, kurse profilet e disolucionit për form-dozën 50 mg dhe gjysmën e form-dozës 100 mg nuk ishin të njëjta çka nënkupton shpejtësi të ndryshme tretjeje apo përthithje, të cilat lënë për dyshime të efektit terapeutik

**Konkluzione dhe rekomandime:** Tabletat e atenololit të marra në studim janë plotësisht në përputhje me kriteret farmakopeale por nuk rekomandohet përdorimi i formave të ndara.

# Kontrolli farmaceutik i disa formave farmaceutike të ngurta afër dhe disa muaj pas datës së skadimit

---

**ARJOLA DEMAJ\*\*; XHULIO RRAPAJ\*\*  
Dr. ENTELA HALOCI\***

\*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Mjekësisë; Universiteti i Mjekësisë Tiranë

\*\*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Barnat që iu kaluar afati i përdorimit shpesh herë përbëjnë një problem në hallka të ndryshme të zinxhirit farmaceutik, duke filluar që nga prodhuesi, depoja farmaceutike, farmacitë e rrjetit të hapur dhe të mbyllur, por edhe për pacientët. Teorikisht këto barna nuk duhen përdorur për shkak të ndryshimeve fiziko-kimike që ato mund të kenë pësuar gjatë ruajtjes së tyre. Megjithatë shpesh herë në rrjetin spitalor, prodhues por edhe nga pacientët për arsye të ndryshme ekonomike shtrohet pyetja a mund të përdoret një bar që është në muajin e fundit të skadencës ose disa muaj pas saj? Sa i dëmshëm mund të jetë ai? Ky studim normal do të duhet të pasohet edhe nga studime plotësuese në lidhje me efektet toksike të këtyre preparateve por ne jemi ndalur tek analiza fiziko-kimike e formave farmaceutike si dhe përcaktimin e cilësisë dhe sasisë të principit aktiv.

**Materiali dhe metoda:** Janë marrë në studim tabletat e losartanit, amlodipinës, teofilinës, naproxenit dhe meprobamatit. Mostrat e barnave janë analizuar me metodikat e analizave të BP(2009). Mostrat janë marrë në mënyrë rastësore nga farmaci dhe depo të ndryshme në Shqipëri.

**Rezultatet dhe diskutimi:** Rezultoi se tabletat të cilat ishin afër 1-3 muaj pas datës së skadencës i plotësonin parametrat teknologjike farmakopeale kurse format që kishin kaluar mbi 3 muaj datën e skadencës kishin luhatje nga limitet farmakopealë për format e ngurta. Principi aktiv në të gjitha mostrat e marra për studim pas datës së skadencës kishte ndryshime të principit aktiv në sasi dhe në cilësi.

**Konkluzione dhe rekomandime:** Në bazë të rezultateve nuk rekomandojmë përdorimin e barnave pas datës së skadencës.



# Produktet zbardhuese të lëkurës me përmbajtje të lartë hidrokinoni

**SONILA DOCI**  
**Dr. EDLIRA NEZA**

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Hidrokinoni është një lëndë që redukon sintezën e melaninës duke bllokuar veprimtarinë e tiroksinazës. Për 50 vite me radhë është përdorur si lëndë mjaft efikase për trajtimin e çrregullimeve të hiperpigmentimit (melazma, fotoplakja etj) Është përdorur gjithashtu në bojërat e flokëve dhe produktet për thonjtë. Studimet kanë treguar se hidrokinoni shkakton: irrimin të lëkurës, dermatit kontakti, okronozis ekzogjene, pigmentimi i syrit (në disa raste dëmtim i përhershëm i kornesë), kancer tek minjtë dhe kafshë të tjera. Që prej 2001 hidrokinoni nuk është i autorizuar të përdoret në produktet zbardhuese të lëkurës në vendet e Bashkimit Evropian. Në 2006 është ndaluar edhe nga FDA-ja. Qëllimi i këtij prezantimi është të informojë konsumatorin në lidhje me sigurinë e produkteve kozmetike.

**Materiale dhe metoda:** Janë kontrolluar informacionet të publikuara në sistemin RAPEX të Bashkimit Evropian duke përdorur hidrokinonin si fjalë kyçe. Informacioni është shqyrtuar nga viti 2005 deri në vitin 2014.

**Rezultate e diskutime:** Nga rezultatet e marra u regjistruan 124 produkte kozmetike me përmbajtje hidrokinoni nga 0.06% deri në 7.1%. Në përqindjen më të lartë këto produkte i përkasin kategorisë së produkteve zbardhuese të lëkurës (90.32%) por gjithashtu locione për trupin (8.06%), vaj për trupin (0.81%) dhe krem ngjyruës për flokët (0.81%). Produktet vinin nga vende si Kongo, Bregu i Fildishtë, Shtetet e Bashkuara, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Polonia, Gjermania, Belgjika dhe Xhamajka. Gjithashtu u gjeten produkte me origjinë të panjohur. Shumë produkte zbardhuese të lëkurës ishin tërhequr nga tregu si rezultat i pranisë së lartë të merkurit dhe të antiinflamatorëve steroid.

**Konkluzione:** Të dhënat e nxjerra nga Sistemi Evropian për Sigurinë e Konsumatorit i Bashkimit Evropian sugjerojnë se produktet zbardhuese të lëkurës mund të përmbajnë lëndë të ndaluara si hidrokinon, merkur dhe antinflatore steroid. Ngelet e dyshimtë siguria e këtyre produkteve në tregjet e hapura dhe të pakontrolluara të vendit tonë. Konsumatori duhet të jetë i kujdesshem në përzgjedhjen e tyre. Lejohen të përdoren produkte që përmbajnë arbutin një analog i hidrokinonit ose ekstrakte bimore që përmbajnë arbutin.

**Fjalë kyçe:** Produkte kozmetike, produkte zbardhuese të lëkurës, hidrokinon, Rapex.

# Parimet bazë të dizenjimit të barnave

**KLEVISA HYSKO; VALBONA ALUSHI**  
**Dr. ENVER MUSTAJ**

Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Historikisht, zbulimi i barnave ka ndodhur kryesisht në mënyrë rastësore. Aktualisht, mbështetur edhe në arritjet e shkencave të tjera, janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen përpjekje në gjetjen dhe zhvillimin e metodave apo strategjive të reja si për identifikimin e komponimit drejtues, ashtu dhe për modelimin molekular të tij, deri në përfitim të molekulave të reja medikamentoze, bazuar në dizenjimin racional.

**Qëllimi** i studimit ka qenë parashtrimi i metodave bashkëkohore që përdoren në procesin e krijimit të barnave, si hap i parë drejt studimeve eksperimentale me ndihmën e programeve kompjuterike.

**Materiale dhe metoda:** Studimi ynë është kompilativ, i mbështetur në shfrytëzimin e një literature bashkëkohore në fushën e dizenjimit të barnave.

**Koncepte e diskutime:** Dizenjimi i barit, i njohur dhe dizenjimi racional i barit, është procesi krijues deri në gjetjen e barnave të reja duke u bazuar në njohuritë mbi objektivin biologjik. Dihet që një molekulë bari përbëhet nga grupe funksionale, përkatësisht farmakofori dhe toksikofori, të vendosur në një formacion gjeometrik të mirë përcaktuar, që mundësojnë ndërveprimin me receptorin. Është e vetëkuptueshme që struktura dhe veprimi janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndërhyrja selektive në çdo pjesë të molekulës bioaktive mund të shkurtojë, zgjasë apo dështojë gjithë procesin e krijimit. Nga perspektiva e dizenjimit të barnave, nëse një toksikofor nuk përputhet me farmakoforin në një molekulë bari të dhënë atëherë është e mundur të ridizenjosh molekulën për të shmangur helmueshmërinë. Megjithatë, nëse farmakofori dhe toksikofori janë pjesë me veti të ngjashme të së njëjtës molekulë, atëherë toksiciteti është i pandashëm nga veçoritë e dëshiruara farmakologjike, çka përbën një vështirësi tjetër në rrugen drejt qëllimit përfundimtar.

**Konkluzione:** Studimi e përftimi i molekulave të reja bioaktive paraqet jo thjesht interes shkencor, por dhe ekonomik e shëndetësor. Me njohuritë e deritanishme është i mundur realizimi i stadeve fillestare të kërkimit të molekulave bioaktive, kandidatë potencial për barna, edhe nga grupe studimore në fakultetin tonë.

**Fjalë kyçe:** dizenjimi i barit, farmakofor, toksikofor, modelim molekular.

# Principet e pozicionimit gjatë procedurave dentare

---

**ALEKSANDËR DAMZI; ELVIS BALLA; RENATO KHANI; ANXHELO SHAHINI**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Teknikat e pozicionimit korrekt janë të rëndësishme pasi parandalojnë diskomfortin dhe dëmtimet gjatë manipulimeve dentare, na mundësojnë një pamje më të qartë të fushës operatore, krijojnë një akses më të mirë gjatë procedurës dhe bëhet e mundur trajtimi i duhur për pacientin. Qëllimi: Qëllimi i prezantimit është të paraqesë në mënyrë të përmbledhur rekomandimet në lidhje me pozicionimin e duhur të mjekut stomatolog gjatë trajtimit.

**Metoda:** Për përgatitjen e këtij prezantimi u bazuam në literaturën bashkëkohore, tekste dhe artikuj për parimet e pozicionimit gjatë trajtimeve dentare.

**Rezultatet:** Nga shqyrtimi i literaturës nxorëm disa rezultate:

Çrregullimet muskuloskeletale hasen në më shumë se 60% të rasteve të "dëmtimeve profesionale".

Më shumë se 80% e dentistëve ankohen për dhimbje në shpinë dhe në pjesën e sipërme të trupit.

Gabimi më i shpeshtë i dentistit është pozicionimi i pacientit më lart sesa bërryli i tij.

**Konkluzionet:** Pozicioni neutral është më i mirë për trupin gjatë procedurave dentare dhe ndikon në uljen e riskut për dëmtimet muskuloskeletale.

Për të shmangur lodhjen, mjeku duhet ta pozicionojë pacientin duke e përshtatur në raport me karrigen e tij.

Sa më i madh të jetë devijimi nga pozicioni neutral, aq më i madh është risku për dëmtime muskulo-skeletale të dentistit.

**Fjalë kyçe:** dëmtim muskuloskeletal, pozicionim korrekt, diskomfort.

# Barodontalgjia

---

**DEJVIS ZENELI**

**Dr. Sh. EDLIRA DEDAJ**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Barodontalgjia është dhimbja dentare e shkaktuar nga ndryshimi i presionit atmosferik. Konsiderohet si një ndodhi sa e rralle, aq edhe e rëndësishme, duke u bazuar në shenjat dhe simptomat e saj të komplikuara. Eksperienat e ekspozimit nën presionin atmosferik i kanë pilotët dhe polumbarët.

**Qëllimi:** Të studiohet dukuria e barodontalgjisë tek pilotët dhe polumbarët.

**Materiali dhe metoda:** Në studimin tonë kemi marrë si target grup Komandën e Forcës Ajrore (Baza Farkë) dhe Komandën e Forcës Detare (Baza Pashaliman).

Mbi popullatën në studim janë kryer ekzaminime ekstra e intraorale, si dhe ekzaminime ndihmëse. Po ashtu pjesë e studimit kanë qenë pyetësorët.

**Rezultate:** Kjo formë e dhimbjes dentare u evidentua në prani të patologjive të ndryshme dentare siç janë infeksionet periapikale akute dhe kronike, karies, kiste dentare të pranishme, mbushje të thella ose të deshtuara, patologji të sinuseve. Pjesa më e madhe e pilotëve dhe polumbarëve e kishin përjetuar një herë gjatë jetës së tyre dukurinë e barodontalgjisë. Një përqindje e lartë e tyre kanë shfaqur sëmundje paradontale.

**Konkluzion:** Në studimin tonë nuk kishte korrelacion midis moshës së pilotëve ose polumbarëve me prevalencën e barodontalgjisë. Fenomeni i barodontalgjisë shfaqej në fluturime nga 8500-18000 ft dhe zhytje mbi 10 m thellësi. Dhimbja gjatë ngritjes mendohet të lidhet me një inflamacion pulpar, kurse në zbritje lidhet me një dhëmb nekrotik ose pulp të ekspozuar. Gazrat që ndodhen midis dhëmbit dhe pjesës së restauruar janë nën ndikimin e ndryshimeve të presionit dhe ky gaz mund të shpërthejë dhe mund të krijojë frakturë. Gjithsesi studiues të ndryshëm kanë arritur në përfundimin se shkaktarët kryesor të këtij procesi nuk janë gjithmonë të kuptueshëm. Mund të ketë lidhje midis dukurisë së barodontalgjisë me hipereminë pulpare ose me gazrat e bllokuar në dhëmb pas një trajtimi jo të plotë të kanalit.

**Fjalë kyçe:** barodontalgjia, presion atmosferik, patologji dentare.

# Kandidoza orale dhe stomatiti protetik tek të protezuarit me proteza të lëvizshme

## **ELIS KANINI**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Dëmtimet e mukozës janë ndër problemet më të shpeshta në të protezuarit me proteza të lëvizshme dhe njohja e kronologjisë së tyre ka rëndësi në praktikën klinike. Ndër to më të shpeshtat janë stomatiti kandidozik, alergjia nga rezina e protezës, Sindroma e Djegies së Gojës etj.

**Qëllimi i punimit:** Sqarimi i faktorëve etiologjikë kryesorë që ndikojnë në rritjen e rasteve me sëmundje kandidozike, si dhe dhënia e njohurive mbi metodat e trajtimit të patologjive.

**Materiali dhe metoda:** Gjatë një periudhe një vjeçare, në Klinikën Universitare "ALDENT" kemi ekzaminuar dhe diagnostikuar 15 pacientë me kandidozë kronike. Këta pacientë janë trajtuar me rrugë të përgjithshme dhe lokale, duke u ndjekur gjatë dhe pas trajtimit. Në 10 pacientë është bërë riprotezimi. Rëndësi e veçantë ju kushtua mënyrës së parandalimit, të mjekimit, si dhe rolit të protezimit në shfaqjen e kandidozës. Lidhur me trajtimin, rëndësi i kemi kushtuar formave kronike të kandidozës dhe diagnozës diferenciale ndërmjet alergjisë nga rezina, Sindromit të Djegies së Gojës, etj. Përsa i përket medikamenteve dhe skemës së mjekimit kemi analizuar antimykotikët lokalë dhe të përgjithshëm dhe mënyrat më efikase për parandalimin e dëmtimeve të ndryshme të mukozës tek protezë-mbajtësit.

**Rezultatet dhe diskutimi:** Në pacientët me kandidozë orale u vu re se faktori protetik, mbajtja e protezës natën, higjiena e dobët, cilësia dhe vjetërsia e protezës ishin faktorë kryesorë në shfaqjen dhe gravitetin e patologjisë. Në pacientë protezëmbajtës prej mbi 10 vitesh kandidozën kronike e hasëm në mbi 65% të tyre.

**Konkluzione:** Në format kronike mjekimi është më i vështirë. Faktorët kryesorë që favorizojnë kandidozën janë: proteza të përgatitura pa zbatuar kushtet teknologjike të përgatitjes, probleme në mirëmbajtjen e protezës nga pacienti dhe higjiena e mangët, proteza të vjetra që nuk zëvendësohen për kohë të gjatë etj.

**Fjalë kyçe:** kandidozë orale, pacientë protezëmbajtës, forma kronike.

# Shkaqet e dështimeve endodontike

---

**ELVIS BALLA; ALEKSANDËR DAMZI; ANXHELO SHAHINI; RENATO XHANI**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Suksesi i trajtimeve endodontike është rritur me avancimin e teknologjisë në fushën e diagnostifikimit dhe trajtimit, por pavarësisht evoluimit të teknologjisë ekzistojnë faktorë të ndryshëm të cilët ndikojnë në suksesin e trajtimeve dhe bëhen shkak për dështimin e tyre.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij punimi është evidentimi i shkaqeve më të mundshme, që çojnë në dështim të trajtimit endodontik dhe mënyra e parandalimit të tyre.

**Materiali:** Për realizimin e këtij punimi jemi bazuar kryesisht në literaturën e huaj, studimeve të realizuara nga autorë të huaj në lidhje me shkaqet e dështimeve endodontike, evidenca shkencore dhe tekste endodontike bashkëkohore.

**Rezultatet:** Duke u bazuar në literaturë, shkaqet më të shpeshta të cilët çojnë në dështimin e trajtimeve endodontike lidhen me procedurat operative të trajtimit kanalar, si mos izolimi i fushës operatore, përpunim jo i plotë i kanalit të rrënjës, mbushje jo e plotë e kanalit, gabime jatrogenike, etj.

**Konkluzione:** Vendosja e diagnozës së saktë, kujdesi gjatë përpunimit të kanalit dhe eliminimi i mikroorganizmave nga kanalet e rrënjëve është çelësi i suksesit të trajtimeve endodontike.

**Fjalë kyçe:** dështime endodontike, kanali i rrënjës, diagnostikim.

# Menaxhimi dhe trajtimi i osteomielitit kronik në mandibul (Raportim rasti)

---

## **ELVIS BARA**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Osteomieliti kronik është inflamacion i shtresës medulare. Prek më shumë mandibulën, ku paraqitet me një kuadër simptomatologjik më të shprehur. Etiologjia e osteomielitit kronik është e lidhur me kariesin dhe komplikacionet e tij, komplikacionet e ekstraksioneve, kistet odontogjene të infektuara, etj. Osteomieliti kronik nuk ka frekuencë të lartë.

**Qëllimi:** prezantimi i një rasti klinik me osteomielit kronik me komplikacion me fistul ekstraorale.

**Materiali dhe metoda:** Pacienti P.K moshë 26 vjeç, paraqitet në klinikën dentare me ankesa, erë e keqe nga goja, dhimbje, mpirje e buzës së poshtme dhe fistul ekstraorale. U mor anamneza dhe u bë ekzaminimi klinik dhe radiologjik. Diagnoza e mundshme "Osteomielit kronik i mandibulës, i shoqëruar me fistul ekstraorale". U fillua mjekimi me antibiotik grupi i penicilinës, amoksisilinë 4X1 gr dhe u planifikua trajtimi kirurgjikal.

**Trajtimi kirurgjikal:** anestezinë lokale, regjionale dhe infiltrative, incizion intraoral, kyretim i kockës së destruktuar, preparim i fistulës ekstraorale. Vazhdon kura me antibiotik për 2 javë.

**Rezultatet:** Osteomieliti kronik vjen si rezultat i kariesit dhe komplikacioneve të tij në një organizëm me imunitet të komprimuar.

**Konkluzionet:** Osteomieliti kronik i mandibulës është patologji e rëndë që pasohet me deformime dhe humbje indore. Rol të rëndësishëm merr parandalimi dhe drejtimi të mjeku specialist.

**Fjalë kyçe:** osteomielit kronik, fistul ekstraorale, trajtim kirurgjikal.

# Traumat dentare

---

**RENATO KHANI; ELVIS BALLA; ALEKSANDËR DAMZI; ANXHELO SHAHINI**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Dëmtimet traumatike të dhëmbëve përbëjnë një sfidë në dentistri. Në literaturë raportohet se 25% e nxënësve të shkollave fillore kanë pësuar së paku një herë traumë dentare. Menaxhimi korrekt i traumës dentare ndikon në jetëgjatësinë e dhëmbit në harkun dentar.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij studimi është që të japim një klasifikim të traumave dentare në sajë të lokalizimit, klinikës dhe gravitetit të tyre.

**Metoda:** Ky punim është i bazuar në literaturën bashkëkohore dhe është përshtatur në mënyrë të tillë që të shërbejë si një manual teorik, dhe sidomos praktik, në shërbimin stomatologjik.

**Rezultatet:** Bazuar në këtë punim, në nxjerrim disa rezultate të cilat konsistojnë në të dhëna statistikore shumë të rëndësishme. Moshë më e rëkshme është mosha 8-12 vjeç në denticionin miks. Djemtë janë më të rëkshme se femrat në raport 2:1. Lloji i traumës që haset më shpesh është kontuzioni. Harku maksilar është më i ekspozuar ndaj traumave.

**Konkluzionet:** Pas përfundimit të këtij punimi, arrijmë në konkluzione të cilat përbëjnë esencën e njohurive mbi traumat dentare.

Dëmtimet traumatike të dhëmbëve, përbëjnë një emergjencë në kabinetin dentar. Prognoza e trajtimit është në raport të drejtë me trajtimin e patologjive traumatike dhëmbore. Menaxhimi i traumave dentare mbetet një problem në praktikën dentare, në sajë të shumë faktorëve të cilët komplikojnë trajtimin. Çdo mjek stomatolog duhet të ketë njohuritë e duhura për diagnozën dhe menaxhimin e një traume dentare.

**Fjalë kyçe:** traumat, emergjencë, menaxhim.



# Hepatitet dhe risku i tyre në kabinetet dentare

---

**SIGI HAXHIAJ; DENIS MIFTARI; GENTIANA KERI; AGON BEJTULLAHU; FLORINDA NITO  
Dr. BLERTA KIKA**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Hepatitet janë infeksione virale të transmetueshme nga kontakti me lëngjet trupore, të një portatori të infeksionit me një njeri të shëndoshë. Hepatitet janë cilësuar si një epidemi e heshtur që vret. 2 milion njerëz në vit marrin hepatit nga injeksionet e pasigurta. Numërohen 1 në 3 persona mbartës të hepatitit. Në Shqipëri ka 250 mijë shqiptarë të sëmurë nga hepatitet. Më i përhapuri është hepatiti B. 780000 persona vdesin çdo vit nga Hepatiti B. Hepatitet janë gjithashtu shkaktar kryesor të kancerit të heparit.

**Qëllimi:** Sensibilizimi i studentëve stomatologë me riskun e transmetimit të hepatitit në kabinetet dentare.

**Metoda:** Për përgatitjen e këtij prezantimi u bazuam në literaturë dhe database shkencore.

Gjithashtu shfrytëzuam raportin e OBSH për ditën botërore ndaj hepatitit për vitin 2015.

**Konkluzioni:** Hepatiti është i rrezikshëm, ka rreth 2 mijë persona të prekur çdo vit,

- 320-480 mijë janë mbartës të hepatitit.
- 10% e rasteve kalojnë në hepatit kronik
- 40% të rasteve cirozë hepatiche
- 5% e rasteve në kancer të heparit

Mjeku stomatolog nuk informohet nga pacienti që është mbartës i hepatitit.

**Fjalë kyçe:** hepatit, mbartës, sensibilizim.

# Sëmundja periodontale dhe pasojat e saj në shtatzëni

---

## **XHESJANA DEDJA**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Qëllimi:** Evidentimi i lidhjes midis shtatzënisë dhe shfaqjes së sëmundjes periodontale si dhe pasojat që ajo mund të sjellë.

**Hyrje:** Kërkimet kanë treguar se sëmundja periodontale në shtatzëni ekspozon fetusin ndaj shumë rreziqeve të ndryshme. Sëmundja periodontale zakonisht fillon me një infeksion bakterial të indit gingival duke e shkatërruar progresivisht këtë ind, si dhe kockën nën të. Shtatzënia shkakton shumë ndryshime hormonale të cilat rrisin rrezikun e zhvillimit të gingivitit dhe paradontitit.

**Materiali dhe Metoda:** Për këtë qëllim është bërë një kërkim në Medline duke përdorur PubMed. Nga ky kërkim janë seleksionuar 5 artikuj të botuara në Anglisht nga 2008-2015. Janë interpretuar të dhënat dhe është bërë përpilimi i studimeve të autorëve të ndryshëm në periudha të ndryshme. Paraqitja e rekomandimeve për kujdesin dentar gjatë kësaj periudhe është bere nga Shoqata Amerikane Dentare.

**Rezultate dhe Diskutime:** Sëmundja periodontale është e pranishme në një numër të konsiderueshëm të grave shtatzëna në nivel botëror. Ky nivel i lartë i sëmundjes periodontale i atribuohet ndryshimeve në nivelin e hormoneve, gjë që promovon një përgjigje inflamatore, e cila rrit rrezikun e zhvillimit të gingivitit dhe paradontitit. Mbi baza shkencore konkludohet se transporti hematogen i bakteve nga zonat me inflamacion periodontal në placentë, membranën fetale dhe kavitetin amniotik mund të shkaktojë procese patologjike të cilat çojnë në komplikacione të shtatzënisë. Nisur nga kjo këshillohet informimi dhe mjekimi oral i femrave në periudhën e shtatzënisë.

**Fjalë kyçe:** Sëmundja periodontale, shtatzënia, higjiena orale.

# Vlerësimi i preparimit të margos gingivale në punimet fikse

## **ENXHILALA**

### **Prof. RUZHDIE QAFMOLLA**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti ALDENT

**Hyrje:** Një aspekt i rëndësishëm për suksesin estetik të punimeve fikse është realizimi i zonës së margos gingivale. Forma e margos gingivale dhe përputhshmëria e kurorës protetike në qafën e dhëmbit varen direkt nga forma e kultit të preparuar. Në lidhje me këtë ka lloje të ndryshme të preparimit të margos gingivale sipas llojit të punimeve fikse.

**Qëllimi:** Të zbatojmë, preparimet chamfer dhe shpatull për punime të ndryshme fikse, si korona metal-pocelan dhe tërësisht metalike.

**Materiali dhe metoda:** Gjatë Tetorit 2015-Mars 2016 u protezuan me proteza fikse 7 pacientë, të moshës 30- 60 vjeç. U preparuan 32 dhëmbë, të ndarë sipas llojit të preparimit të zonës gingivale në këtë mënyrë: të 12 dhëmbë u aplikua linja e preparimit chamfer, të 14 dhëmbë linja shpatull dhe të 6 dhëmbë kombinimi chamfer-shpatull.

Për linjën chamfer u përdor freza torpedo, e cila siguron mundësinë e preparimit të zonës marginale pa e dëmtuar këtë të fundit. Vlerësimi i rezultateve u bë në bazë të të dhënave objektive, subjektive dhe radiologjike.

**Rezultatet dhe Diskutimet:** U preparuan 7 premolarë maksilarë dhe mandibularë (faqja linguale). Linja e preparimit shpatull u aplikua në 17 dhëmbë ose 53,12% nga këto 10 kaninë dhe 7 centralë e lateralë. Në pjesën frontale dhëmbët kaninë zënë 58,8% të gjithë dhëmbëve frontal. Kjo shpjegohet me faktin se kaninët shërbejnë si dhëmbë shtyllë për urat fikse kur mungojnë premolarët. Vetëm në 66,6% (ose 4 dhëmbë) u përdorën për urë totale duke përfshirë dy kaninët dhe molarët. Vlerësimi i rezultateve u bë në bazë të të dhënave objektive, subjektive dhe radiologjike ku u pa që mbyllja cervikale ishte shumë e qëndrueshme, gingiva normale dhe u sigurua një estetikë e lartë. Radiologjikisht nuk u panë dëmtime të procesit alveolar dhe kurorat qëndruan nën nivelin gingivar 0.5 mm.

**Konkluzion:** Mbështetur në përvojën tonë modeste konkludojmë:

- 1- Për të siguruar një estetikë të mirë të punimit duhet të zbatohet rigorozisht linja marginale.
- 2- Linja e mbylljes duhet të zbatohet sipas llojit të kurorës.

**Fjalë kyçe:** margo gingivale, linja chamfer, linja shpatull.

# Risqet në Kabinet/Klinika Dentare

---

**ILDA ÇUNI; MIGENA SABASHI; PRANVERA TAHIRI; ENXHI BODINAKU**  
**Prof. AGIM SHEHI**

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti ALDENT

---

**Hyrje:** Risqet në studiot dentare mund të përkufizohen si një rrezik për një person gjatë punës nga një material në punë, substancë, proces apo situatë që paraqitet. Si në çdo mjedis tjetër i punës, stomatologjia mund të shoqërohet me efekte të dëmshme për mjekun stomatolog dhe stafin, të referuara si rreziqet profesionale. Në këto risqe përfshihen risqet kimike, biologjike, fizike dhe ergonomike. Ky prezantimin përshkruan dhe analizon këto risqe dhe metodat parandaluese.

**Qëllimi:** Risqet në kabinetet/ klinikat dentare dhe ndikimi në shëndetin e stafit dentar. Të rekomandojmë masat parandaluese të këtyre rreziqeve.

**Materialet dhe Metodot:** Në studim janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë eksperiencat e deritanishme dhe literatura të ndryshme bashkëkohore si dhe janë analizuar libra të ndryshëm për higjienën dentare.

**Konkluzioni:** Në studim janë analizuar risqet në kabinetin dentar, si kimike, fizike, biologjike dhe ergonomike si dhe është parë që këto rreziqe ndikojnë në shëndetin e mjekut stomatolog si dhe të stafit dentar. Këto dëmtime vijnë shpesh herë si pasojë e një përkujdesje jo të mirë për masat mbrojtëse si dhe higjienën dentare. U pa se përdorimi i aparateve radiologjike, rrezeve ultraviolet të llambës halogjene, instrumenteve vibruese, por gjithashtu dhe i materialeve kimike si amalgam apo akrilik si dhe të qenit në kontakt të vazhdueshëm me materiale biologjike të infektuara si gjaku, saliva dhe aerosolet kanë shkaktuar problem nga më të lehtat e të kurueshmet deri tek më të rëndat e të pashërueshmet tek mjeku stomatolog e stafi dentar.

**Fjalë kyçe:** risk, studio dentare, masa mbrojtëse.

